



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 2004/2

PËR BARAZI GJINORE.

Kuvendi i Kosovës

Duke u bazuar në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, nenet 3.1, 3.2 (a), (b), (c), (d), 5.1 (gj), 5.7, 9.1.26 (a) dhe 9.3.3,

Duke ndier nevojën e krijimit të kushteve ligjore për barazi gjinore në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë, Kuvendi i Kosovës

Miraton:

Ligjin për Barazi Gjinore të Kosovës

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi i Ligjit

1.1. Me këtë Ligj mbrohet, trajtohet dhe vendoset, barazia ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

1.2. Ky Ligj përcakton kushte dhe mundësi për barazi gjinore përmes politikave që mbështesin zhvillimin e gjithanshëm dhe përmirësimin, sidomos të pozitës së femrave, në mënyrë që ato të jenë të vlerësuara dhe të gëzojnë autoritet në familje dhe shoqëri.

1.3. Garantimi i të drejtave të barabarta është detyrë e tërë shoqërisë dhe nënkupton mënjanimin e pengesave në realizimin e barazisë gjinore.

1.4. Barazia gjinore bazohet në parimin e sjelljes së njëjtë dhe në parimin e mundësive të barabarta, ndërsa jetësohet me masat pozitive dhe me politikë të vetëdijësuar për barazi gjinore.

1.5. Ky Ligj përcakton masat e përgjithshme dhe të veçanta për garantimin e të drejtave të barabarta si dhe përcakton subjektet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre.

Neni 2 PËRKUFIZIMET TERMINOLOGJIKE

2.1. Barazi gjinore do të thotë pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozitë të barabartë, mundësi të barabarta për të gëzuar të gjithat të drejtat e tyre dhe për të vënë në shërbim potencialet e tyre individuale në zhvillimin e shoqërisë si dhe të kenë përfitim të barabartë nga të arriturat e këtij zhvillimi.

2.2. Trajtim i barabartë gjinor do të thotë mënjanim i formave të drejtpërdrejta dhe të tërthorta të diskriminimit gjinor.

2.3. Diskriminim i drejtpërdrejtë gjinor do të thotë trajtim i pabarabartë i ndonjë individi në krahasim me një individ të gjinisë së kundërt në rrethana të njëjta apo të ngjashme.

2.4. Diskriminim i tërthortë gjinor do të thotë vënia e individit të njëres gjini në pozitë jo të barabartë me dispozitat asnjane, standartet apo trajtim të pabarabartë në rrethana të njëjta ose të ngjashme, përveç rasteve kur këto dispozita, standarte apo ky trajtim është i domosdoshëm dhe nëse mund të justifikohet me fakte objektive që nuk bazohen posaçërisht në ndonjërin gjini.

2.5. Nxitja e individit tjetër në diskriminim gjinor në kuptim të këtijë Ligji konsiderohet diskriminim gjinor.

2.6. Ngacmimi dhe ngacmimi seksual paraqesin diskriminim gjinor.

2.7. Ngacmimi përfshin çdo formë të sjelljes që ka për qëllim ose që paraqet cënim të dinjitetit personal.

2.8. Ngacmimi seksual përfshin çdo formë të sjelljes së padëshiruar seksuale verbale dhe joverbale, fizike ose simbolike, që në të njëjtën kohë ka për qëllim ose paraqet cënim të dinjitetit personal.

2.9. Masat ligjore janë masa të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së plotë të femrave dhe meshkujve në shoqëri, të cilat japin përparësi specifike në mënyrë që pjesëtarëve të gjinisë së caktuar t'u mundësohet qasje e barabartë në të gjitha fushat e jetës shoqërore, të mënjanohet pabarazia gjinore ekzistuese, ose t'u sigurohen të drejta të cilat më herët nuk iu kanë takuar.

2.10. Masat e përgjithshme janë masa të natyrës normative, përmes të cilave diskriminimi gjinor parandalohet me anë të ligjeve të cilat i rregullojnë fushat e veçanta, sjelljet në rrethana të caktuara apo qasjen e duhur për garantimin e trajtimit të barabartë gjinor, siç janë ndëshkimet që duhet ndërmarrë ndaj individëve në rast të shkeljes së këtyre kufizimeve ose kërkesave.

2.11. Masat e veçanta janë masa të përkohshme të cilat kanë për qëllim garantimin e të drejtave të barabarta gjinore dhe promovimin e barazisë gjinore në fushat specifike të jetës shoqërore, në të cilat është identifikuar përfaqësimi i pabarabartë gjinor apo pozita e pabarabartë e personave që i përkasin njëres gjini.

2.12. Përfaqësimi i pabarabartë në kuptim të paragrafit 2.11, është atëherë kur përfaqësimi i njëres gjini, në një fushë të posaçme shoqërore apo në një segment të kësaj fushe, është më i ulët se 40%.

Neni 3
INSTITUCIONET DHE ORGANET UDHËHEQËSE

3.1. Me zbatimin e masave ligjore dhe afirmative vendoset pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike, në mënyrë që pjesëmarrja në këto institucione të arrijë nivelin e pjesëmarrjes së tyre te popullata e përgjithshme e Kosovës.

3.2. Pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve sipas nenit 3 pika 3.1 arrihet në rastet kur pjesëmarrja e një gjinie në institucione, organe apo në nivele të pushtetit është 40 %.

3.3. Gjatë emërimit në organet qendrore dhe në organet e qeverisjes lokale, si dhe te personat e tjerë juridik me pushtet publik, duhet të respektohet pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe meshkujve në përputhje me paragrafin 3.2.

3.4. Organet kompetente gjatë emërimit të anëtarëve të këshillave, komisioneve dhe organeve përfaqësuese brenda dhe jashtë Kosovës duhet të përfillin përfaqësimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në këta këshilla, komisione dhe organe përfaqësuese.

3.5. Gjatë emërimit të institucioneve, ndërmarjeve publike, rrugëve, të respektohet barazia gjinore.

SUBJEKTET PËRGJEGJËSE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE
DHE KOMPETENCAT E TYRE

Neni 4
KUVENDI I KOSOVËS

4.1. Kuvendi i Kosovës respekton parimet e përfaqësimit të barabartë gjinor gjatë themelimit të organeve punuese dhe të delegacioneve në pajtim me rregulloren e tij të punës.

4.2. Kuvendi i Kosovës shqyrton dhe miraton Rezolutën për Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

4.3. Kuvendi i Kosovës shqyrton dhe miraton çdo dy vjet raportin e Qeverisë për realizimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

QEVERIA DHE MINISTRITË

4.4. Qeveria harton Programin e Kosovës për Barazi Gjinore. Për përmbushjen e këtij qëllimi, Qeveria emëron një grup të përbërë nga përfaqësues të ministrive, Zyrës për Barazi Gjinore të Kosovës, të komunave, të institucioneve publike, të shoqërisë civile dhe nga ekspertët.

4.5. Qeveria i paraqet Kuvendit të Kosovës projektrezolutën mbi Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

4.6. Çdo dy vjet Qeveria i paraqet raport Kuvendit të Kosovës për realizimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore.

4.7. Detyrë dhe përgjegjësi e qeverisë dhe ministrive në fushën e barazisë gjinore është edhe promovimi dhe garantimi i të drejtave të barabarta gjinore.

4.8. Qeveria në kuadër të fushëveprimit të saj realizon qëllimet e këtij ligji duke ndërmarrë masat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë ligj.

4.9. Qeveria formon Këshillin ndërministror, anëtarë të të cilit janë Zyrtarët për Barazi Gjinore të ministrive. Kompetencat dhe detyrat e këtij këshilli përcaktohen me rregullore të veçantë nga Qeveria.

4.10. Gjatë përgatitjes së rregulloreve dhe programeve të tyre, ministrinë duhet të respektojnë dispozitat e këtij ligji.

4.11. Ministrinë bashkëpunojnë me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës për hartimin e projektligjeve, ndryshimin e ligjeve ekzistuese dhe shqyrtojnë rekomandimet e kësaj Zyre përkitazi me projektligjet dhe dokumentet e tjera në aspektin e barazisë gjinore, para se këto projektligje t'i dorëzohen qeverisë për të marrë vendime.

4.12. Çdo ministri zgjedh zyrtar/zyrtare për barazi gjinore i cili/ e cila kryen detyrat e koordinatorit/koordinatores për çështje gjinore. Kompetencat e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në ministrinë përkatëse përcaktohen me rregullore të veçantë nga secila ministri, duke u mbështetur në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/36 për Shërbimin Civil të Kosovës.

4.13. Zyrtari/Zyrtarja për barazi gjinore siç parashihet në paragrafin 4.12 është përgjegjës për përmbushjen e detyrave nga aspekti i barazisë gjinore, në kuadër të kompetencave të ministrisë, duke u bazuar në këtë Ligj dhe në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës.

ORGANET E QEVERISJES LOKALE

4.14. Organet e qeverisjes lokale, në pajtim me kompetencat e tyre, promovojnë dhe krijojnë mundësi të barabarta, hartojnë politikat e tyre duke u bazuar në barazinë gjinore dhe miratojnë masa dhe ndërmarrin aktivitete të nevojshme për krijimin e mundësive të barabarta për femra dhe meshkuj.

4.15. Organet e qeverisjes lokale themelojnë Zyrën për Barazi Gjinore dhe zgjedhin Zyrtarin/Zyrtaren për Barazi Gjinore në komunë. Kompetencat e Zyrtarëve për Barazi Gjinore në komuna përcaktohen me rregullore të veçantë, në bazë të këtij ligji, nga Departamenti për Administrim Lokal i Ministrisë të Shërbimeve Publike dhe Rregullores për Shërbimin Civil të Kosovës.

4.16. Vendimet që marrin organet e qeverisjes lokale, para miratimit duhet të shqyrtohen në aspektin e barazisë gjinore edhe nga zyrtari/zyrtarja për Barazi Gjinore në komunën përkatëse.

4.17. Zyrtari/Zyrtarja për Barazi Gjinore në komunë bashkëpunon me Zyrën për Barazi Gjinore të Kosovës

Neni 5

ZYRA PËR BARAZI GJINORE

5.1. Qeveria e Kosovës themelon Zyrën për Barazi Gjinore si institucion të veçantë qeveritar.

5.2. Zyra për Barazi Gjinore ka këto kompetenca:

- a) zbaton dhe monitoron dispozitat e këtij Ligji dhe rregulloreve të miratuara në bazë të tij;
- b) i propozon qeverisë dhe ministrive hartimin, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve dhe rregulloreve, si dhe miratimin e masave të tjera;
- c) përpilon dhe propozon politikën për promovimin e barazisë gjinore dhe mbikëqyr zbatimin e saj;
- d) mbikëqyr zbatimin e marrëveshjeve dhe akteve ndërkombëtare që kanë të bëjnë me barazinë gjinore;
- e) përgatit raporte për Kosovën mbi përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore, të cilat miratohen nga qeveria;
- f) koordinon punën rreth përgatitjes së Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, dhe monitoron zbatimin e tij;
- g) bashkëpunon me Zyrtarët për Barazi Gjinore në ministri dhe qeveritë lokale;
- h) bashkëpunon me organizatat jo-qeveritare të cilat janë aktive në fushën e barazisë gjinore dhe siguron financimin e pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre;
- i) bashkëpunon me institucionet publike dhe siguron financim të pjesshëm për projekte apo aktivitetet e tyre;
- j) propozon kushtet dhe kriteret për financim të pjesshëm të cilin e përcakton qeveria;
- k) koordinon aktivitetet e drejtuara në zbatimin e normave të përgjithshme të barazisë gjinore, duke përfshirë afrimin e ndihmës profesionale për zhvillimin e metodave dhe teknikave të përshtatshme;
- l) propozon nisma për hulumtim dhe analiza në fushën e barazisë gjinore;
- m) punon në ngritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë gjinore;
- n) i raporton cdo vit qeverisë për veprimtarinë e Zyrës për vitin paraprak, e më së voni deri në fund të muajit Mars.

Neni 6

AVOKATI/AVOKATJA PËR BARAZI GJINORE

6.1. Avokatin/Avokaten për barazi gjinore (në tekstin e mëtejme: Avokati/Avokatja) e zgjedh dhe shkarkon Kuvendi i Kosovës me propozim të Qeverisë së Kosovës.

6.2. Avokati/Avokatja ka zëvendës/zëvendëse të cilin/të cilën e zgjedh Kuvendi i Kosovës me propozim të Avokatit/Avokates.

6.3. Avokati/Avokatja dhe zëvendësi/zëvendësja e tij/e saj, për t'u zgjedhur në postet përkatëse, duhet të plotësojnë këto kushte:

- a) diplomë në shkencat juridike;
- b) përvojë nga fusha e mbojtes së të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore;
- c) të kenë të dhënë provimin e jurisprudencës.

6.4. Avokati/Avokatja dhe zëvendësi/zëvendësja i tij/e saj shkarkohen nga detyra në rastin:

- a) e dorëheqjes së pranuar nga Kuvendi i Kosovës;
- b) e humbjes së përhershme të aftësisë për kryerjen e detyrës;
- c) e shqiptimit të vendimit të plotfuqishëm gjyqësor për dënim për veprë penale;
- d) e moskryerjes së detyrave të përcaktuara me këtë ligj.

6.5. Avokati/Avokatja përcjell dhe mbikqyr zbatimin e këtij Ligji dhe për këtë, një herë në vit i raporton Kuvendit të Kosovës e në rast nevojë edhe më shpesh.

6.6. Avokati/Avokatja shqyrton rastet e shkeljes së rregullave të barazisë gjinore, rastet e diskriminimeve gjinore kundër individëve ose grupeve të individëve të cilat janë kryer nga organet qeverisëse ose organe tjera të cilat kanë autorizime publike, të punësuarit në këto organe, punëdhënësit dhe personat tjerë fizik dhe juridik.

6.7. Çdokush mund t'i drejtohet avokatit/avokates për shkak të shkeljeve të bëra në baza gjinore, pa marrë parasysh a është i/e dëmtuar drejtpërdrejt apo jo.

6.8. Avokati/Avokatja u raporton, propozon dhe sugjeron organeve kompetente, e në rast të shkeljes të së drejtës me elemente të veprës penale ose kundërvajtëse propozon iniciimin e procedurës penale apo kundërvajtëse.

6.9. Avokati/Avokatja ka të drejtë t'i propozojë Kuvendit të Kosovës iniciimin e procedurës për vlerësimin e pajtueshmërisë së këtij Ligji me Kornizën Kushtetuese dhe pajtueshmërinë e rregulloreve me këtë Ligj dhe Kornizën Kushtetuese kur vlerëson se shkelja e parimeve të barazisë gjinore është për shkak të mospajtueshmërisë së ligjeve apo rregulloreve të tjera me Kornizën Kushtetuese apo me këtë Ligj.

6.10. Organet e qeverisjes dhe personat juridik me autorizime publike, punëdhënësit dhe personat e tjerë juridik e fizik janë të detyruar që menjëherë t'i paraqesin të gjitha informatat e duhura dhe të mundësojnë qasjen dhe shikimin e dokumentacionit pas kërkesës së avokatit/avokates, më së voni deri në 30 ditë prej ditës së dërgimit të kërkesës.

6.11. Avokati/Avokatja dhe personat e punësuar në Zyrën e tij/saj, janë të detyruar që të dhënat me të cilat janë njohur gjatë ushtrimit të detyrës së avokaturës t'i ruajnë si sekret zyrtar.

6.12. Avokati/Avokatja përpilon rregulloren e punës me të cilën rregullon mënyrën dhe organizimin e punës, sistemin e brendshëm për shërbimet e ekspertëve si dhe çështjet tjera me rëndësi për punën në pajtim me ligjin dhe rregulloret në fuqi.

Neni 7

SHQYRTIMI I RASTEVE TË SHKELJES SË BARAZISË GJINORE

- 7.1. Individët, organizatat jo-qeveritare, sindikatat dhe organizatat tjera të shoqërisë civile mund të paraqesin Avokatit/Avokates për Barazi Gjinore kërkesë me shkrim për shqyrtimin e një rasti që ka të bëjë me shkelje të barazisë gjinore.
- 7.2. Avokatit/Avokates për Barazi Gjinore mund ti paraqiten edhe kërkesa anonime me shkrim, dhe ai/ajo mund ti shqyrtojë nëse ato përmbajnë informata të mjaftueshme.
- 7.3. Kërkesa për shqyrtimin e një rasti, i paraqitet Avokatit/Avokates për Barazi Gjinore jo më vonë se një vit nga dita kur ka ndodhur rasti i shkeljes së barazisë gjinore.
- 7.4. Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore mund të shqyrtojë rastin e shkeljes edhe pas skadimit të afatit nëse ai/ajo e konsideron çështjen të rëndësishme për zbatimin e këtij ligji.
- 7.5. Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore shqyrton kërkesat vetëm për rastet e shkeljes së barazisë gjinore të parapara me ligj.
- 7.6. Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore, para marrjes së vendimit për rastin në shqyrtim, mund të thërrasë palët për sqarimin e rastit.
- 7.7. Mbrenda 30 (tridhjetë) ditëve Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore shqyrton kërkesën e paraqitur dhe merr vendim lidhur me të.
- 7.8. Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore njofton palët për vendimin e marrë dhe kërkon nga ato zbatimin e vendimit më së largu 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e njoftimit të vendimit.
- 7.9. Vendimi i Avokatit/Avokates mund ti nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor në pajtim me ligjet në fuqi.

Neni 8

FINANCIMI I AVOKATIT/AVOKATES PËR BARAZI GJINORE DHE ZYRËS PËR BARAZI GJINORE TË KOSOVËS

Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore dhe Zyra për Barazi Gjinore e Kosovës financohen nga Buxheti i Kosovës.

Neni 9

MBLEDHJA E INFORMATAVE DHE STATISTIKAT GJINORE

- 9.1. Të dhënat dhe informatat statistikore dhe jo - statistikore të cilat i mbledhin, i evidentojnë dhe i përpunojnë organet qendrore dhe lokale, shërbimet dhe institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe private si dhe subjektet e tjera paraqiten sipas struktures gjinore.
- 9.2. Programet, raportet, analizat dhe projektet të cilat i përgatisin organet qendrore, lokale, institucionet publike, ndërmarrjet publike dhe private si dhe subjektet e tjera përfshijnë aspektin gjinor.

9.3. Institucionet e Kosovës, të cilat në bazë të ligjeve përkatëse janë kompetente të mbledhin, të evidentojnë, të përpunojnë dhe të bëjnë analizën e statistikave, përfshijnë treguesin gjinor në gjithë veprimtarinë e tyre, regjistrimin e popullsisë, anketimet demografike, dhe çdo lloj tjetër të anketimit.

9.4. Të dhënat dhe informatat statistikore dhe jo-statistikore që mbledhen, evidentohen dhe përpunohen në pajtim me paragrafin 9.1 janë pjesë përbërëse e evidences statistikore dhe lejohet qasje në to në pajtim me dispozitat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale të qytetarëve si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare.

Neni 10 PARTITË POLITIKE

10.1. Partitë politike të regjistruara në regjistrin e partive politike, përcaktojnë metodat dhe masat për përfshirjen dhe përfaqësimin e femrave dhe meshkujve në pajtim me nenin 3.2.

Neni 11 SHOQËRIA CIVILE

11.1. Organizatat jo-qeveritare, shoqatat dhe fondacionet bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre në fushën e barazisë gjinore me institucionet qeveritare si dhe me institucione të tjera të përcaktuara me këtë Ligj.

11.2. Subjektet e shoqërisë civile kontribuojnë në zbatimin e këtij Ligji.

Neni 12 EKONOMIA

12.1. Në legjislacionin ekonomik, financiar, të punësimit dhe mirëqënies sociale si dhe në programet makro dhe mikro - ekonomike, financiare, privatizim, përfshirë edhe të drejtën për trashëgimi dhe pronësi, kredi dhe burime natyrore duhet të mundësohet qasje e plotë dhe e barabartë për femra dhe meshkuj.

12.2. Organet përgjegjëse dhe personat juridik me autorizime publike si dhe institucionet financiare në kushte të barabarta u sigurojnë femrave dhe meshkujve qasje në mjete dhe shpërndarje të mjeteve të ndara për nxitjen e krijimit të biznesit dhe vetëpunësimit.

Neni 13 PUNA

13.1. Sektori publik, privat si dhe institucionet ligjvënëse dhe ekzekutive në sektorin e punës dhe të punësimit, sigurojnë të drejta dhe mundësi të barabarta për femra dhe meshkuj.

13.2. Vendi i lirë i punës hapet njësoj për femra dhe meshkuj.

13.3. Shpallja ose publikimi i vendit të lirë të punës nuk mund të përmbajë fjalë apo shprehje që diskriminojnë në baza gjinore. Kjo dispozitë nuk vlen nëse qëllimi i shpalljes dhe

publikimit bëhet për të balancuar strukturën gjinore brenda një sektori profesional, dhe kjo duhet të vëhet në dukje në shpallje.

13.4. Kriteret dhe kushtet për zgjedhjen e kandidatëve për vende të punës në çdo degë veprimtarie, në të gjitha shkallët profesionale, në sektorin publik dhe privat, vendosen mbi bazat e barazisë gjinore.

13.5. Punëdhënësi/Punëdhënësjë, është i/e detyruar të paguajë pagë të njëjtë për femra dhe meshkuj, për punën e njëjtë dhe për punën me vlerë të njëjtë, si dhe siguron kushtet e barabarta të punësimit dhe të punës dhe të gjitha të drejtat e barabarta të punës.

13.6. Punëdhënësi/Punëdhënësjë siguron që femrat dhe meshkujt të kenë mundësi të barabarta për të vazhduar shkollimin dhe aftësimin profesional dhe të përcjellin trajnimet të cilat mbahen për të shtuar shkathhtësitë profesionale ose të përgatiten për profesione të tjera.

13.7. Punëdhënësi/Punëdhënësjë apo institucioni që bën aftësimin profesional dhe secili individ që merr pjesë në aftësimin profesional nuk u lejoheq që të diskriminojnë asnjë individ në baza gjinore.

13.8. Punëdhënësi/Punëdhënësjë, duhet të sigurojë trajtim të barabartë për femra dhe meshkuj në sektorin e punës, dhe të marrë masa në mënyrë që profesionet të mos jenë të kategorizuara si punë specifike vetëm për femra ose vetëm për meshkuj.

13.9. Punëdhënësit marrin masa të nevojshme për t'u mundësuar femrave dhe meshkujve të përshtasin detyrimet e tyre profesionale dhe familjare. Organizimi i punës dhe orarit, në pajtim me nevojat e tregut të punës dhe gjendjen familjare të të punësuarve, bëhet në mënyrë që të sigurojë kthimin në vendin e njëjtë të punës pas pushimit të lindjes, pushimit prindëror, pushimit të abortit, pushimit mjeksor ose pas kohës së kaluar jashtë vendit të punës për shkaqe urgjente familjare, apo aftësime profesionale.

13.10. Është e drejtë e çdo të punësuarit femër apo meshkull të anëtarësohet dhe aktivizohet në sindikatat e punëtorëve apo të punëdhënësjëve apo në çdo organizatë tjetër profesionale, përfshirë edhe përfitimet që dalin nga kjo anëtarësi.

13.11. Ndalohet ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës.

13.12. Ndalohet përjashtimi nga puna i një të punësuarit/punësuarëje në rastin kur ai/ajo kërkon zbatimin e këtij ligji.

13.13. Ndalohet përjashtimi nga puna, pushimi i përkohshëm nga puna, padrejtësia lidhur me sigurinë në punë, kushtet e punës ose vlerësimin e punës së tij/saj si pasojë e ankesës së tij/saj për ngacmim seksual ose diskriminim në bazë të gjinisë.

13.14. Ndalohet diskriminimi mbi bazat gjinore në rast të zvogëlimeve dhe mbylljes së vendeve të punës.

13.15. Puna e papaguar e femrave dhe meshkujve vlerësohet kontribut në zhvillimin e familjes dhe shoqërisë në raste të:

- a) kujdesit për mirëqenien familjare;
- b) kujdesit për fëmijët;
- c) kujdesit për anëtarë të tjerë të familjes;
- d) punës në bujqësi dhe ekonomi familjare,etj;

Të drejtat që dalin nga ky paragraf realizohen me legjislacionin e sigurimit social, politikave dhe masave tjera.

13.16. Mbrojtja në punë, për femra dhe meshkuj dhe përfitimet e sigurimit social për punën me orar të shkurtuar, për punën e përkohshme dhe për punën që kryhet nga shtëpia sigurohet me ligjet në fuqi.

Neni 14 **ARSIMI DHE EDUKIMI**

14.1. Në të gjitha nivelet e arsimit dhe edukimit duhet të mundësohet arsimimi dhe edukimi i barabartë i femrave dhe meshkujve për pjesëmarrje e tyre aktive në shoqëri, në jetën familjare dhe në tregun e punës.

14.2. Organi përgjegjës për arsim dhe intitucionet në fushën e arsimit dhe të edukimit në të gjitha nivelet krijojnë, zbatojnë dhe mbikqyrin politikat e veprimit për sigurimin e barazisë gjinore me qëllim të trajtimit të njëjtë të femrave dhe meshkujve, veçanërisht për: a) përkjet:

- a) qasjes në arsim dhe edukim;
- b) arsimit dhe edukimit lidhur me çështjet e barazisë gjinore;
- c) përgatitjes, miratimit dhe zbatimit të programit arsimoro-edukativ;
- d) hartimit të materialeve dhe teksteve shkollore dhe rishikimit të materialeve dhe teksteve shkollore ekzistuese;
- e) hulumtimit të statusit të gjinive në shoqërinë kosovare, si një ndër mënyrë specifike në fushën e arsimit;
- f) përfshirjes së femrave dhe meshkujve në trajnime të arsimimit profesional dhe të këshillimit për ato profesione të cilat deri tani janë konsideruar tradicionalisht si profesione vetëm për meshkuj ose vetëm për femra;
- g) përfshirjes së barabartë të femrave dhe meshkujve në lëmenjtë e sportit dhe aktiviteteve të lira, gjatë orarit arsimor.

14.3. Në shkolla dhe institucione të tjera arsimore dhe pedagogjike ndalohet çdo lloj diskriminimi gjinor.

Neni 15 **MEDIAT**

15.1. Me anë të politikave programuese, të gjitha mediat (media të shtypura, media audio-vizuale, media elektronike) duhet të ndikojnë në kultivimin e vetëdijes së përgjithëshme për barazinë e femrave dhe meshkujve:

- a) duke organizuar emisione edukativo-arsimore;
- b) duke siguruar mundësi për paraqitje dhe pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe të meshkujve;

- c) duke promovuar rolin e barabartë të femrave dhe meshkujve në shoqëri;
- d) duke siguruar informacione të sakta dhe të plota mbi barazinë gjinore.

15.2. Ndalohet emetimi i programeve, botimi dhe publikimi i materialeve dhe informatave si dhe shpërndarja e informatave në formën elektronike mbi baza të diskriminimit gjinor.

15.3. Ndalohet shfaqja publike dhe paraqitja e çdo individi në mënyrë ofenduese, nënçmuese apo poshtëruese përsa i përket gjinisë dhe orientimit seksual.

Neni 16

BARAZIA GJINORE DHE TË DREJTAT CIVILE

16.1. Moshë madhore për të dy gjinitë në Kosovë është 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç.

16.2. Martesa njihet me ligj me aktin e kurorëzimit dhe sjell të drejta dhe detyrime sipas ligjit nëse me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.

16.3. Kurorëzimi lejohet me arritjen e moshës madhore, nëse me ligj të veçantë nuk është paraparë ndryshe.

16.4. Femra ose mashkulli, nuk mund të ketë më tepër se një kurorëzim në të njëjtën kohë.

16.5. Martesat e kushtëzuara, të dhunshme dhe në kundërshtim me vullnetin e personave që do të lidhin martesë, denohen me ligj.

16.6. Pasuria e krijuar gjatë jetës në martesë regjistrohet në regjistrat publik, si pronë e përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve.

16.7. Institucioni që bën regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik është i detyruar të veprojë në pajtim me paragrafin 16.6 të këtij Ligji.

16.8. Puna e përbashkët e bashkëshortëve me të cilën fitohet pasuria e përbashkët, konsiderohet kontribut i barabartë për krijimin e pasurisë së përbashkët.

16.9. Pasuria e përbashkët e regjistruar si pronë e përbashkët në pajtim me paragrafin 16.7, administrohet bashkarisht dhe nuk mund të tjetërsohet pa pëlqimin e bashkëshortëve.

16.10. Në rast të shkurorëzimit të bashkëshortëve pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta.

16.11. Në rast vdekje të njërit prej bashkëshortëve, pasuria trashëgimore ndahet ndërmjet bashkëshortit/bashkëshortes dhe trashëgimtarëve të tjerë në pajtim me ligjin.

16.12. Fëmijët, femra dhe meshkuj trashëgojnë pasurinë në mënyrë të barabartë.

16.13. Trashëgimtarët, femra dhe meshkuj, mund të disponojnë me pjesën e tyre trashëgimore dhe ta tjetërsojnë, pas regjistrimit si pasuri e tyre trashëgimore.

16.14. Femrat dhe meshkujt kanë të drejtë për qasje të barabartë në sistemin e sigurisë dhe mirëqenies sociale gjatë tërë jetës.

Neni 17

DISPOZITAT NDËSHKUESE

17.1. Punëdhënësi/Punëdhënësja në rast të shkeljes së paragrafit 13.5 të këtij Ligji, dënohet me gjobë prej 1,000 deri në 5,000 Euro.

Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 13.5 të këtij ligji , denohet me gjobë prej 500 deri në 1.500 Euro.

17.2. . Punëdhënësi/Punëdhënësja në rast të shkeljes së paragrafit 13.12 dhe 13.13 të këtij Ligji, dënohet me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro.

Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 13.12 dhe 13.13 të këtij ligji , dënohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 euro

17.3. Personat juridik, në rast të shkeljes së paragrafit 15.2 të këtij Ligji, dënohen me gjobë prej 5,000 deri në 10,000 Euro.

Personi përgjegjës në rast të shkeljes së paragrafit 15.2 të këtij ligji , denohet me gjobë prej 1.000 deri 3.000 Euro

17.4. Institucioni i autorizuar dhe personi përgjegjës për regjistrimin e pasurisë në regjistrat publik, në rast të shkeljes së paragrafit 16.7 të këtij Ligji dënohet me gjobë prej 10,000 deri në 20,000 Euro.

17.5. Mjetet e mbledhura nga gjobat derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës.

Neni 18

DISPOZITAT KALIMTARE

18.1. Në afat prej 6 (gjashtë) muajsh prej hyrjes në fuqi të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës i paraqet Kuvendit të Kosovës, Rezolutën mbi Programin e Kosovës për Barazi Gjinore.

18.2. Në afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, Qeveria e Kosovës shpall Rregulloren për themelimin e Zyrës për Barazi Gjinore.

18.3. Në afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, Qeveria e Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës, Avokatin/Avokaten për Barazi Gjinore.

18.4. Në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimimit të propozimit nga paragrafi 18.3, Kuvendi i Kosovës emëron Avokatin/Avokaten për Barazi Gjinore.

18.5. Në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, Avokati për Barazi Gjinore i propozon Kuvendit të Kosovës, Zëvendësin/Zëvendësen e tij/e saj.

18.6. Në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e pranimimit të propozimit nga paragrafi 18.5, Kuvendi i Kosovës zgjedhë Zëvendësin/Zëvendësen e Avokatit/ Avokates për Barazi Gjinore.

18.7. Në afat prej 3 (tre) muajsh nga hyrja në fuqi e këtij Ligji, Ministrinë duhet të kenë zgjedhur Zyrtarët për Barazi Gjinore.

18.8. Në afat prej 3 (tre) muajsh qeveritë komunale zgjedhin Zyrtarin/ Zyrtaren për Barazi Gjinore në Komunë.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19

19.1. Garantohet mbrojtja gjyqësore e barazisë gjinore.

19.2. Ndalohet diskriminimi gjinor me ligj në të gjitha fushat e jetës shoqërore në Kosovë.

19.3. Me këtë Ligj nuk ndalohet zbatimi i ligjeve të tjera në fuqi me të cilat ndëshkohet shkelja e barazisë gjinore.

NENI 20

HYRJA NË FUQI E LIGJIT

Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Kosovës dhe shpalljes së tij.

Ligji Nr.2004/2
19 Shkurt 2004

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

akademik Nexhat Daci

LIGJI PËR BARAZI GJINORE I KOSOVËS

Përmbajtja

Preambula

Nenet

1. - Dispozitat e Përgjithshme (Neni 1)
2. - Përkufizimet Terminologjike (Neni 2)
3. - Institucionet dhe Organet Udhëheqëse (Neni 3)
4. - Subjektet Përgjegjëse për Arritjen e Barazisë Gjinore dhe Kompetencat e tyre (Neni 4)
 - 4.1 - Kuvendi i Kosovës
 - 4.4 - Qeveria dhe Ministrinë
 - 4.14 - Organet e Qeverisjes Lokale
5. - Zyra për Barazi Gjinore (Neni 5)
6. - Avokati/Avokatja për Barazi Gjinore (Neni 7)
7. - Shqyrtimi i rasteve të shkeljes së barazisë gjinore
8. - Financimi i Avokatit/Avokates për Barazi Gjinore dhe Zyrës për Barazi Gjinore të Kosovës (Neni 8)
9. - Mbledhja e Informatave dhe Statistikat Gjinore (Neni 9)
10. - Partitë Politike (Neni 10)
11. - Shoqëria Civile (Neni 11)
12. - Ekonomia (Neni 12)
13. - Puna (Neni 13)
14. - Arsimi dhe Edukimi (Neni 14)
15. - Mediat (Neni 15)
16. - Barazia Gjinore dhe të Drejtat Civile (Neni 16)
17. - Dispozitat Ndëshkuese (Neni 17)
18. - Dispozitat Kalimtare (Neni 18)
19. - Dispozitat Përfundimtare (Neni 19)
20. - Hyrja në Fuqi e Ligjit (Neni 20)